



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	Drejtoria e Urbanizmit
Periudha raportuese	<b>Maj 2016</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Heroina Maloku

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Në Sektorin e urbanizmit ka vazhduar puna sipas dinamikës së njëjtë, përderisa kërkesat janë shtuar. Takimet e Grupit profesional - Kolegjiumit nuk kanë mundur të realizohen në formatin e plotë të grupit, por grupi pjesërisht ka realizuar takime me zyrtarët që kanë kërkuar konsulta lidhur me lëndë konkrete.



Gjatë këtij muaji janë pranuar 153 kërkesa të ndryshme, prej të cilave 23 kërkesa për leje ndërtimi, pra ka pasur rritje në krahasim me muajt e kaluar sa i përket kërkesave.

Janë përcaktuar kushte për 17 (shtatëmbëdhjetë) ndërtesa, janë dhënë 16 (gjashtëmbëdhjetë) leje ndërtimi, 3 (tri) ndërtesa shumëkatëshe ndërsa të tjerat shtëpi individuale, janë dhënë 18 (tetëmbëdhjetë) vendime - pëlqime të ndryshme, ku 17 (shtatëmbëdhjetë) janë për pronë, derisa një tjetër vendim për lejim të kryerjes së punëve ndërtimore, janë refuzuar 24 (njëzet e katër) kërkesa, si dhe shumë informime për plotësim dokumentacioni, aktvendime kompensimi e të ngjashme.

*Të dhëna statistikore për Sektorin e Urbanizmit:*

<i>Lëndët e pranuar - maj</i>	<b>Kushte ndërtimore</b>	<b>Leje ndërtimi</b>	<b>Konstatime për refuzim</b>	<b>Vendime - pëlqime</b>	<b>Lëndë në procedurë</b>
<b>153</b>	17	16	24	17	<b>168</b>

Krahasimi mes muajve Janar, Shkurt, Mars:



Po vazhdon regjistrimi i lëndëve në Sistem të vrojtimit të lëndëve.

Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët kanë qenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrje të projekteve, si dhe në grupe punuese për hartim të legjislacionit në MMPH. Janë në trajtim edhe objektet e papërfunduara nga procesi i legalizimit, ku disa nga tyre po kanë probleme të procedohen për shkak të mangësive ligjore dhe pritjet plotësim-ndryshimi i Ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Grupi profesional ka realizuar takime me qytetarë të interesuar për konsulta para aplikimit për leje ndërtimi ose kushte ndërtimi, sidomos për objektet e kategorisë II, në trend të njejtë sikur edhe muajin e kaluar rreth 50 takime, të cilëve u janë dhënë sqarimet dhe janë udhëzuar për procedurë të mëtutjeshme. Probleme të identifikuara edhe më herët, janë mosinteresi i pronarëve për t'u përfshirë me zgjidhje urbane, në shumë raste nga një parcelë, të cilat pengonin zhvillimin e sipërfaqeve të mëdha të planifikuara për ndërtim.

Nuk ka përfunduar finalizimi i unifikimit të dokumenteve që lëshohen nga Urbanizmi në mungesë të kompletimit të grupit punues për këtë aktivitet, derisa po vazhdon procedimi i lëndëve me format e fundit të punuara.

Gjatë muajit raportues kemi trajtuar 24 lëndë të reja, të aplikuar gjatë procesit të fundit të legalizimit, përpos atyre që kanë filluar trajtimin gjatë muajve paraprak, gjithashtu kemi pranuar vazhdimisht plotësime të lëndëve. 21 ndërtime janë legalizuar, ndërkohë disa të tjera duhet të bëjnë plotësime për ta kompletuar aplikacionin e tyre për legalizim dhe disa të tjera janë në proces të legalizimit.

## **2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .**

- Zbatimi i bazës ligjore për planifikim e ndërtim - shqyrtimi i lëndëve, duke respektuar afatet ligjore;
- Unifikimi i dokumenteve që lëshohen nga Sektori;
- Vlerësimi i lëndëve nga Grupi profesional - Kolegjiumi, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- Takimet me qytetarë të interesuar për zgjidhjet urbane deri në arritjen e zgjidhjes dhe përgatitjet para aplikimit për kushte ndërtimore;
- Dita botërore e Mjedisit, me 05.06.2016;
- Fushata vetedijesuese për shfrytëzimin e transportit publik, e cila në muajin në vijim do të tenderohet.

## **3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

- Është nënshkruar Memorandum i mirëkuptimit në mes të MMPH-së, Komunës së Prishtinës, KEDS-it dhe KUR "Prishtina" për funksionalizimin e një zyreje shërbyese për marrjen e pëlqimeve nga këto kompani në procedurë të lejes së ndërtimit;
- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Plotësimi i Permit Tracking System me lëndët e muajve në vijim;
- Publikimi i lejeve të ndërtimit në ueb-faqen e Komunës;
- Mbikëqyrja e projekteve që realizohen nga investimet kapitale të Komunës;
- Pjesëmarrje në vlerësime të ofertave sa i përket punëve ndërtimore për investimet e Komunës;
- Takimet e rregullta të zyrtarëve shqyrtues me grupin profesional - kolegjiun për lëndë konkrete;
- Takime të shumta me qytetarë për arritjen e zgjidhjeve urbane para kushteve ndërtimore;
- Përgjigje në kërkesa të ndryshme sa i përket punës së sektorit;
- Pjesëmarrje në panairin e ndërtimit "Expokos 2016";
- Takime të shumta me organizata ndërkombëtare, si dhe institucione vendore;

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.**

- Vazhdohet me zbatimin e bazës ligjore, duke u përpjekur që të respektohen afatet ligjore;
- Pjesëmarrje në Grupi punues për plotësim ndryshimin e UA-së për procedurat e aplikimit për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimi;
- Po bëhen - caktohen kushte ndërtimi, duke i reflektuar ndryshimet në to, pas nënshkrimit të memorandumit me MMPH, KEDS dhe KUR "Prishtina" për funksionalizimin e një zyreje shërbyese për proces të lejes së ndërtimit;
- Po bëhen përgatitjet për prezantimin e ndryshimeve në procedura pas nënshkrimit të memorandumit me MMPH, KEDS dhe KUR "Prishtina", për funksionalizimin e një zyreje shërbyese për proces të lejes së ndërtimit për qytetarët;
- Po vazhdon puna në sistemin e informimit për monitorimin e procedurës së marrjes së lejes së ndërtimit nga qytetarët si masë e transparencës;
- Po punohet në unifikimin e dokumenteve që lëshohen nga Drejtoria, si masë e funksionalizimit të skemës së re të ristrukturuar të stafit ;
- Po punohet në rritjen e efikasitetit të punës së grupit profesional – Kolegjiut, në mënyrë që të mos paraqiten vonesa në shqyrtim të lëndëve;
- Po punohet në zgjidhje urbane të ndryshme deri në miratimin e tyre;
- Po vazhdon publikimi i të gjitha lejeve të lëshuara ndërtimore nga Sektori i urbanizmit, duke punuar me kronologji nga lejet më të fundit;
- Janë duke u identifikuar pengesat në zbatim të planeve.

##### **4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese**

##### **4.1.3 Takimet me palë**

Takimet me palë kanë vazhduar të martave dhe të enjteve, me përjashtime, edhe ditëve të tjera sipas nevojës.

#### **5. TAKIMET ME INSTITUCIONE TË TJERA**

Edhe gjatë muajit maj, sikurse edhe më herët, janë realizuar shumë takime me institucione qendrore - ministritë e linjës, si dhe organizata të huaja, me qëllim të realizimit të aktiviteteve të ndryshme dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional. Është realizuar një takim me AKP-në sa i përket pronave të KBI-së, për të cilat pritet një përgjigje nga ta.

## 6. DISKUTIMET PUBLIKE/TAKIMET ME QYTETARË

### 6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

### 6.1.2 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

Në tabelë gjeni të dhënat për Sektorin e urbanizmit sa i përket kërkesave të pranuar, të përfunduara dhe në procedurë:

<i>Lëndët e pranuar - janar</i>	<i>Të kryera - mars</i>	<i>Në procedurë - mars</i>
153	92	168

*Nga 92 lëndë, 24 janë refuzime, të cilat bëhen në bashkëpunim me zyrtarët ligjorë, derisa janë kryer edhe shumë aktivitete në proces të përcaktimit të kushteve ndërtimore, si dhe lëshimit të lejeve të ndërtimit, që nuk mund konsiderohen si kryerje e lëndës, por aktivitete që ndikojnë në kryerje të lëndëve.*

*10 lëndë të pranuar, leje mjedisore ,  
9 aktvendime për kompensim në sektorin e mjedisit,  
5 të përfunduara, leje mjedisore komunale.*

## 7. TAKIME TË TJERA

Gjatë këtij muaji Sektori i urbanizmit ka realizuar shumë takime edhe me drejtoritë e tjera, si Drejtoria e Pronës dhe Financave, Drejtoria e Kadastrit dhe Drejtoria e Infrastrukturës, duke mos i lënë anash edhe takimet e shpeshta me Inspektoratin, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve.

## 8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Sfidë për Sektor mbetet edhe ngarkesa me lëndë nga legalizimi për objektet e papërfunduara, të regjistruara në regjistrin e ndërtimeve pa leje. Sfidë mbetet edhe realizimi i marrëveshjeve sa i përket pronës, si dhe reflektimi ndryshimeve në kadastër.

**9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.**

- Mbetet rekomandimi: Të realizohen punët e nevojshme për sigurimin e një zyreje me tavolinë dhe karrige, ekskluzivisht për takime – prezantime, duke siguruar pajisjet e nevojshme për të mundësuar punën drejtëpërdrejt në kompjuter, monitor dhe pajisjet përcjellëse për punë grupore;
- Të mundësohen trajnime ose vizita zyrtare të stafit sa i përket procedurës për pajisje me leje ndërtimi, si dhe për regjistrimin, skedimin dhe arkivimin e dokumenteve.

**10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues**

- Vazhdimi me shqyrtimin e lëndëve të bartura nga viti paraprak (miratim, refuzim);
- Procedimi i lëndëve sipas afatit kohor të paraparë me ligj;
- Prezantimi i ndryshimeve në procedurë pas nënshkrimit të memorandumit me MMPH, KEDS dhe KUR “Prishtina”, për funksionalizimin e një zyreje shërbyese për proces të lejes së ndërtimit për qytetarët;
- Analizat dhe listimi i aktiviteteve të nevojshme përgatitore për sistemin online për pajisje me leje ndërtimi;
- Organizimi i takimit të punës për përfundimin e formave standarde të dokumenteve që lëshohen nga DU-ja;
- Konsultime me palë në lidhje me projektet - në formë të shtypur në fleta A3 (para fazës së aplikimit për leje);
- Vazhdimi i plotësimit me informata të programit - Permit tracking system dhe organizimi i azhurnimit të të dhënave dhe publikimi i lejeve të lëshuara në web-faqe;
- Aktiviteti rreth avancimit të shërbimit të informimit të qytetarëve për procedurat e urbanizimit;
- Vazhdimi i publikimit të lejeve të ndërtimit në web-faqe të Komunës;
- Miratimi dhe publikimi i taksës së ndërtimit, si dhe tarifat përkatëse.

**11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.**